

PA1.nr.1233/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.SH., nga fsh. ..., Komuna e Vushtrisë, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, B.SH., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Vushtri, P.nr. 451/2018, të dt.24.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 14.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet- si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit B.SH., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Vushtri, P.nr. 451/2018, të dt.24.10.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dega në Vushtri, P.nr. 451/2018, të dt.24.10.2018, është shpallur fajtor i akuzuari B.SH., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë, në shumën prej 600 euro, të cilin dënim është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti do të zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje pre 30 ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 euro.

Në kuptim të nenit 67 par 1 lidhur me par 2 të KPK, i ka shqiptuar dënimin plotësues, ndalimi i drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej 1 viti.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest juridiko-civil.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato, sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25€, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë i akuzuari B.SH., për shkak të vendimit për dënimin me gjobë dhe dënimin plotësues, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, sa i përket sanksionit penal, ashtu që të akuzuarit t'iu shqiptohet dënimi më i butë, kurse dënimi plotësues të hiqet.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën PPA/II.nr.1237/2018, datë 08.01.2018, ka propozuar që të refuzohet ankesa e të akuzuarit B.SH., kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Kolegji i kësaj gjykate para se të vlerëson shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe ankesën e ushtruar, ka pranuar me dt. 11.01.2019, parashtresën nga i akuzuari, se tërhiqet nga ankesa e ushtruar.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar çështjen penale si tersi, ka ardhur në përfundim se i akuzuari është tërhequr nga ankesa, ashtu që, të njëjtën e ka bërë duke shfrytëzuar dispozitën ligjore nga neni 400 të KPPK dhe ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë si i tillë nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, si dhe vendimit për dënimin.

Pasi që i akuzuari është tërhequr nga ankesa, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se ankesa nuk do të shqyrtohet, kurse aktgjykimi i ankimuar është vendosur në të vërtetohet në kuptim të nenit 401 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVES
PA1.nr.1233/18, datë 14.01.2019

B.profesionale,
Leonita Lajçi

Anëtarët e kolegjit:
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq